LIGJ
Nr.10 090, datë 5.3.2009

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRKOMBËTARE "PËR MUNICIONET THËRRMUESE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërkombëtare "Për municionet thërrmuese".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6100, datë 19.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONFERENCA DIPLOMATIKE
PËR MIRATIMIN E KONVENTËS PËR MUNICIONET THËRRMUESE

CCM/77, 30 maj 2008
Origjinali në anglisht, frëngjisht, spanjisht

Dublin 19–30 maj 2008

Shtetet palë në këtë Konventë,

tepër të shqetësuara për popullatat civile dhe individët civilë të cilët vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore të konflikteve të armatosura;

të vendosura t'i japin fund një herë e përgjithmonë vuajtjeve dhe fatkeqësive të shkaktuara nga municionet thërrmuese në momentin e përdorimit të tyre, kur ato nuk funksionojnë më sipas qëllimit të tyre të mëparshëm ose kur janë të braktisur;

të shqetësuara që mbeturinat e municioneve thërrmuese po vrasin apo gjymtojnë civilët, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë dhe humbjen e jetës, pengojnë rehabilitimin dhe rindërtimin pas konfliktit, vonojnë ose ndalojnë kthimin e refugjatëve dhe personave të shpërngulur brenda për brenda vendit, mund të ndikojnë negativisht në përpjekjet për ndihmesën humanitare kombëtare e ndërkombëtare në lidhje me vendosjen e paqes, si dhe kanë dhe pasoja të tjera të rënda të cilat mund të vazhdojnë për shumë vite pas përdorimit;

tepër të shqetësuara gjithashtu dhe për rreziqet që paraqesin rezervat e mëdha kombëtare të municioneve thërrmuese që mbahen për përdorim operacional dhe të vendosur për të siguruar shkatërrimin e tyre shumë të shpejtë;

duke besuar si të nevojshme që të kontribuojnë me efikasitet e në një mënyrë të bashkërenduar në zgjidhjen e sfidës së largimit të mbeturinave të municioneve thërrmuese në të gjithë botën, dhe për të siguruar shkatërrimin e tyre;

të vendosura gjithashtu të sigurojnë realizimin e plotë të të drejtave të të gjitha viktimave nga municionet thërrmuese dhe të njohin dinjitetin e tyre të qenësishëm;

të vendosura të bëjnë maksimumin e tyre në dhënien e ndihmesës ndaj viktimave të municioneve thërrmuese, duke përfshirë kujdesin mjekësor, rehabilitimin dhe mbështetjen psikologjike ndaj tyre, si dhe sigurimin e tyre social dhe ekonomik;

duke njohur nevojën për t'i dhënë ndihmesë sipas moshës dhe gjinisë viktimave të municioneve thërrmuese dhe për të trajtuar nevojat e veçanta të grupeve të cenueshme;

duke pasur parasysh Konventën për të drejtat e njerëzve me paaftësi, që ndër të tjera, kërkon që shtetet palë në këtë Konventë të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të të gjithë njerëzve me paaftësi pa asnjë lloj diskriminimi që ka lidhje me paaftësinë;

të kujdesshëm në lidhje me nevojën për të bashkërenduar siç duhet përpjekjet e ndërmarra në forma të ndryshme për të mbrojtur të drejtat dhe nevojat e viktimave të llojeve të ndryshme të armëve, dhe të kujdesshëm në shmangien e diskriminimit ndërmjet viktimave të llojeve të ndryshme të armëve;

duke ripohuar që në rastet të cilat nuk mbulohen nga kjo Konventë ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, civilët dhe luftëtarët mbeten nën mbrojtjen dhe autoritetin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare, që vjen nga traditat e vendosura, nga parimet e humanizmit dhe në varësi të ndërgjegjes publike;

të kujdesshëm gjithashtu edhe për grupet e armatosura që dallohen nga forcat e armatosura të një shteti, në asnjë rrethanë, nuk do të lejohen të përfshihen në ndonjë veprimtari që u ndalohet palëve të shteteve të kësaj Konvente;

duke mirëpritur mbështetjen shumë të gjerë ndërkombëtare për normën ndërkombëtare që ndalon minat kundërnjeri, frymëzuar nga Konventa e 1997-ës për ndalimin e përdorimit, grumbullimit, prodhimit dhe transferimit të minave kundërnjeri dhe për shkatërrimin e tyre;

duke mirëpritur gjithashtu miratimin e protokollit për mbeturinat shpërthyese të luftës, shtojcë tek konventa për ndalimet ose kufizimet për përdorimin e disa armëve të caktuara konvencionale, të cilat mund të konsiderohen të jenë tepër të rrezikshme ose të kenë efekte të pakontrollueshme, dhe hyrjen e tij në fuqi më 12 nëntor 2006, si dhe duke dëshiruar të rrisin mbrojtjen e civilëve nga efektet e mbeturinave të municioneve thërrmuese në mjediset e pas konflikteve;

duke pasur parasysh gjithashtu dhe rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë dhe rezolutën 1612 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për fëmijët në konfliktin e armatosur;

duke mirëpritur ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në rang kombëtar, rajonal dhe global gjatë viteve të fundit të cilat kanë pasur si qëllim ndalimin, kufizimin ose zhdukjen e përdorimit, grumbullimit, prodhimit dhe transferimit të municioneve thërrmuese;

duke theksuar rolin e ndërgjegjes publike në çuarjen më tej të parimeve të humanizmit ashtu siç shihet dhe në thirrjen globale për t'i dhënë fund vuajtjeve të civilëve që shkaktohen nga municionet thërrmuese dhe duke njohur përpjekjet e ndërmarra për këtë qëllim nga Kombet e Bashkuara, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Koalicioni për Municionet Thërrmuese dhe shumë organizata të tjera joqeveritare në të gjithë botën;

duke ripohuar deklaratën e konferencës së Oslos për municionet thërrmuese, në të cilën, ndër të tjera, shtetet njihnin pasojat e rënda të shkaktuara nga përdorimi i municioneve thërrmuese dhe u zotuan për të përfunduar në vitin 2008 një instrument të detyrueshëm ligjor i cili do të ndalonte përdorimin, prodhimin, transferimin dhe grumbullimin e municioneve thërrmuese që shkaktojnë dëme të papranueshme ndaj civilëve, dhe që do të ngrinte një kuadër për bashkëpunimin dhe ndihmesën që do të sillte masat, kujdesin dhe rehabilitimin e duhur për viktimat, për pastrimin e zonave të prekura, edukimin për pakësimin e rrezikut dhe shkatërrimin e stoqeve;

duke theksuar dëshirën për të ftuar praninë e të gjitha shteteve në këtë Konventë dhe të vendosur për të punuar shumë për të nxitur universalizimin e saj dhe zbatimin e plotë të saj;

duke u bazuar në parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare për humanizmin, në veçanti parimin që e drejta e palëve në një konflikt të armatosur të zgjedhin metodat ose mjetet e

luftës nuk është e pakufizuar, dhe për rregullat që palët në një konflikt duhet të dallojnë ndërmjet popullsisë civile dhe luftëtarëve, si dhe ndërmjet objekteve civile dhe objektivave ushtarake dhe në këtë këndvështrim t'i drejtojnë operacionet e tyre vetëm kundër objektivave ushtarake, dhe që në sjelljen e operacioneve ushtarake duhet të kushtohet kujdes i vazhdueshëm për të kursyer popullsinë civile, civilët dhe objektet civile dhe që popullsia civile dhe individët civilë të gëzojnë mbrojtjen e përgjithshme kundër rreziqeve që vijnë nga operacionet ushtarake,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Detyrimet e përgjithshme dhe qëllimi i zbatimit

1. Çdo shtet palë, në asnjë rrethanë:

a) nuk duhet të përdorë municione thërrmuese;

b) nuk duhet të zhvillojë, prodhojë, të marrë, grumbullojë, mbajë ose transferojë tek askush, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, municione thërrmuese;

c) nuk duhet të ndihmojë, nxisë ose tërheqë dikë tjetër për t'u përfshirë veprimtari aktivitete që janë të ndaluara për shtetet palë në këtë Konventë.

2. Paragrafi 1 i këtij neni, me ndryshimet përkatëse, zbatohet *mutatis mutandis* për aeroplanët bombardues shpërthyes, të cilët janë projektuar në mënyrë të posaçme që të shpërndahen ose të çlirohen nga shpërndarësit e fiksuar në aeroplan.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet për minat.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Viktima të municioneve thërrmuese" i referohet të gjithë personave të cilët janë vrarë ose vuajnë dëmtime fizike ose psikologjike, humbje ekonomike, përjashtim shoqëror ose cenim thelbësor të përmbushjes së të drejtave të tyre shkaktuar nga përdorimi i municioneve thërrmuese. Ata përfshijnë ato persona që janë prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga municionet thërrmuese, si dhe familjet dhe bashkësitë e tyre të prekura nga ky fenomen.

2. "Municione thërrmuese" do të thotë municione konvencionale që janë projektuar të shpërndajnë apo çlirojnë nënmunicione shpërthyese, ku secili peshon më pak se 20 kilogramë, dhe përfshin ato nënmunicione shpërthyese. Nuk përfshihen, sa më poshtë:

a) një municion apo nënmunicion që është projektuar të shpërndajë flakë, tym, piroteknikë ose mbetje; ose një municion që është projektuar vetëm për një rol të caktuar në mbrojtjen ajrore;

b) një municion ose nënmunicion që është projektuar të prodhojë efekte elektrike ose elektronike;

c) një municion që, me qëllim që të shmangen efektet e zonave të pakontrolluara dhe rreziqet që vijnë nga nënmunicionet e pashpërthyera, ka të gjitha këto karakteristika:

i) secili municion përmban më pak se dhjetë nënmunicione shpërthyese;

ii) çdo nënmunicion shpërthyes peshon më shumë se katër kilogramë;

iii) secili nënmunicion shpërthyes është projektuar të gjejë dhe të merret me një objekt të vetëm të synuar;

iv) çdo nënmunicion shpërthyes është i pajisur me një mekanizëm elektronik vetëshkatërrues;

v) Çdo nënmunicion shpërthyes është i pajisur me një veti elektronike vetëçaktivizuese;

3. "Nënmunicion shpërthyes" do të thotë një municion konvencional, i cili, me qëllim që të kryejë detyrën e tij, shpërndahet ose çlirohet nga një municion thërrmues dhe është projektuar që të funksionojë duke shpërthyer një ngarkesë shpërthyese para goditjes, në momentin e goditjes apo pas goditjes.

4. "Municion thërrmues i pashpërthyer" i referohet municionit thërrmues që është qëlluar, hedhur, lëshuar ose nxjerrë në një farë forme dhe i cili duhet të kishte shpërndarë apo çliruar nënmunicionet e veta shpërthyese, por që në fakt nuk e ka bërë këtë gjë.

5. “Nënmunicion i pashpërthyer” i referohet një nënmunicioni shpërthyes që është shpërndarë apo çliruar, apo shkëputur nga një municion thërrmues dhe nuk ka arritur të shpërthejë.

6. “Municione thërrmuese të braktisura” i referohet municioneve thërrmuese ose nënmunicioneve shpërthyese që nuk janë përdorur dhe që janë lënë mënjanë apo hedhur diku, dhe që nuk janë më nën kontrollin e palës që i ka lënë apo hedhur diku. Ato mund të ishin ose jo përgatitur për t’u përdorur.

7. “Mbetjet e municioneve thërrmuese” do të thotë municione thërrmuese të pashpërthyera, municione thërrmuese të braktisura, nënmunicione të pashpërthyera dhe pjesë thërrmuese të pashpërthyera.

8. “Transferim” përfshin, përveç lëvizjes fizike të municionit të pashpërthyer për në ose nga territori kombëtar, transferimi i titullit dhe kontrolli mbi municionet thërrmuese, por nuk përfshin transferimin e territorit që përmban mbetje të municioneve thërrmuese.

9. “Mekanizmi vetëshkatërrues” i referohet një mekanizmi të future me funksion automatik i cili është shtesë e mekanizmit fillestar kryesor i municionit dhe i cili siguron shkatërrimin e municionit në të cilin është futur.

10.“Vetëçaktivizimi” do të thotë nxjerrje automatikisht jashtë funksionit e municioneve nëpërmjet shkarkimit të pakthyeshëm të një komponenti, për shembull e një baterie, që është thelbësore për funksionimin e municionit.

11. “Zonë e prekur me municione thërrmuese” do të thotë një zonë e njohur ose e dyshuar që përmban mbeturina të municioneve të thërrmuara.

12. “Mina” i referohet municionit të projektuar për t’u vendosur nën, mbi ose afër tokës ose sipërfaqe të tjera dhe që shpërthen nga prania, afrimi apo kontakti me një person apo automjet.

13. “Pjesa thërrmuese shpërthyese” do të thotë një municion konvencional, që peshon më pak se 20 kilogramë, që nuk vihet vetë në lëvizje dhe që për të kryer detyrën e vet, shpërndahet ose çlirohet nga një shpërndarës, dhe është projektuar të funksionojë me anë të shpërthimit të një ngarkese shpërthyese para goditjes, në momentin e goditjes ose pas goditjes.

14. “Shpërndarësi” do të thotë një kontejner që është projektuar që të shpërndajë ose çlirojë pjesë thërrmuese shpërthyese dhe që është i fiksuar tek një avion në momentin e shpërndarjes apo çlirimit.

15. “Pjesë thërrmuese e pashpërthyer” do të thotë një pjesë thërrmuese e pashpërthyer që është shpërndarë, çliruar ose shkëputur nga një shpërndarës dhe që nuk ka shpërthyer.

Neni 3

Ruajtja dhe shkatërrimi i stoqeve

1. Çdo shtet palë, në përputhje me rregulloret kombëtare, do të ndajë të gjitha municionet thërrmuese nën juridiksionin e vet dhe do t’i kontrollojë nga municionet e mbajtura për përdorim operacional dhe do t’i regjistrojë për t’i shkatërruar.

2. Çdo shtet palë ndërmerr të shkatërrojë ose sigurojë shkatërrimin e të gjitha municioneve thërrmuese që u përmendën në paragrafin 1 të këtij neni sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tetë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë. Çdo shtet palë ndërmerr të sigurojë metodat e shkatërrimit në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit.

3. Nëse një shtet palë mendon se nuk do të jetë në gjendje të shkatërrojë ose të sigurojë shkatërrimin e të gjitha municioneve thërrmuese që u përmendën në paragrafin 1 të këtij neni brenda tetë viteve të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë, ai mund të dorëzojë një kërkesë takimit të shteteve palë ose konferencës së rishikimit për shtyrjen e afatit për përfundimin e shkatërrimit të këtyre municioneve thërrmuese për një periudhë prej deri katër vjetësh. Një shtet anëtar, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të kërkojë shtyrje shtesë prej deri në katër vjetësh. Shtyrjet e kërkuara nuk duhet të kalojnë numrin e viteve shumë të nevojshme vetëm për atë shtet anëtar për të përmbushur detyrimet e saj sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Çdo kërkesë për shtyrje duhet të parashtrojë:

a) kohëzgjatjen e shtyrjes së propozuar;

b) një shpjegim të hollësishëm të shtyrjes së propozuar, duke përfshirë mjetet financiare dhe teknike të disponueshme ose që kërkohen nga pala shtet për shkatërrimin e të gjitha municioneve thërrmuese që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni dhe, aty ku ekzistojnë, edhe rrethanat e jashtëzakonshme që e justifikojnë këtë kërkesë;

c) një plan se si dhe kur do të përfundohet shkatërrimi i stoqeve;

d) sasinë dhe llojin e municioneve thërrmuese dhe nënmunicioneve shkatërruese që mbahen me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë dhe të gjitha municionet shtesë thërrmuese ose nënmunicionet shpërthyese të zbuluara pas kësaj hyrjeje në fuqi;

e) sasinë dhe llojin e municioneve thërrmuese dhe nënmunicioneve shpërthyese të shkatërruara gjatë periudhës së përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, dhe

f) sasinë dhe llojin e municioneve thërrmuese dhe nënmunicionet shpërthyese që mbeten për t'u shkatërruar gjatë shtyrjes së propozuar dhe normën vjetore të shkatërrimit që pritet të arrihet.

5. Takimi i shteteve palë ose konferencës së rishikimit, duke marrë parasysh faktorët e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, do të vlerësojë kërkesën dhe do të vendosë me shumicë votash të shteteve palë që janë të pranishme dhe do të votojnë nëse duan ta plotësojnë kërkesën për shtyrje. Shtetet palë mund të vendosin të japin një shtyrje më të shkurtër sesa ajo që kërkohet dhe mund të propozojnë standarde për shtyrjes, sipas rasteve. Kërkesa për shtyrje afati duhet të dorëzohet minimumi nëntë muaj para takimit të shteteve palëve ose konferencës së rishikimit, ku dhe do të trajtohet.

6. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1 të kësaj Konvente, lejohet mbajtja ose marrja e një numri të kufizuar municionesh thërrmuese dhe nënmunicioneve shpërthyese për zhvillimin dhe trajnimin në municionet thërrmuese dhe kapjen e nënmunicioneve shpërthyese, teknikat e pastrimit apo shkatërrimit, ose për zhvillimin e kundërmasave të municioneve thërrmuese. Sasia e nënmunicioneve shpërthyese të mbajtura ose të marra nuk duhet të tejkalojë numrin minimal që është absolutisht i nevojshëm për këto qëllime.

7. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1 të kësaj Konvente, lejohet transferimi i municioneve thërrmuese në një palës shtet tjetër për qëllimin e shkatërrimit, si dhe për qëllimet e përshkruara në paragrafin 6 të këtij neni.

8. Shtetet palë që mbajnë, marrin apo transferojnë municione thërrmuese apo nënmunicione shpërthyese për qëllimet e përshkruara në paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni do të dorëzojnë një raport të hollësishëm për përdorimin e planifikuar dhe përdorimin aktual të këtyre municioneve thërrmuese dhe nënmunicioneve shpërthyese dhe llojin e tyre, sasinë dhe numrat e serive. Nëse municionet thërrmuese ose nënmunicionet shpërthyese transferohen në një shtet tjetër palë për këto qëllime, raporti duhet të përfshijë referencën ndaj palës marrëse. Një raport i tillë duhet të përgatitet çdo vit gjatë të cilit një shtet palë mban, blen apo transferon municione thërrmuese apo nënmunicione shpërthyese dhe do t'i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara jo më vonë se 30 prilli i vitit pasardhës.

Neni 4

Pastrimi dhe shkatërrimi i mbetjeve të municioneve thërrmuese dhe edukimi për pakësimin e rrezikut

1. Çdo shtet palë merr përsipër të pastrojë dhe shkatërrojë, ose të sigurojë pastrimin dhe shkatërrimin e mbeturinave të municioneve thërrmuese të lokalizuara në zonat e prekura me municione thërrmuese nën juridiksionin ose kontrollin e tij, si më poshtë:

a) Aty ku mbeturinat e municioneve thërrmuese ndodhen në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë, një pastrim apo shkatërrim i tillë do të përfundohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se dhjetë vjet nga ajo datë.

b) Aty ku, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë, municionet thërrmuese janë bërë mbeturina municionesh thërrmuese të lokalizuara në zona që janë nën juridiksionin apo kontrollin e tij, pastrimi dhe shkatërrimi duhet të përfundohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se

dhjetë vjet pas përfundimit të veprimeve luftarake aktive gjatë të cilave këto municione thërrmuese shndërrohen në mbeturina të municioneve thërrmuese; dhe

c) Pas përmbushjes së detyrimeve që parashtrohen në nënparagrafët (a) dhe (b) të këtij paragrafi, ai shtet palë do të bëjë një deklaratë për përmbushjen e detyrimeve në takimin pasues të shteteve palë.

2. Gjatë përmbushjes së detyrimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, secili shtet palë do të ndërmarrë masat e mëposhtme sa më shpejt të jetë e mundur, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 6 të kësaj Konvente në lidhje me bashkëpunimin dhe ndihmesën ndërkombëtare:

a) Vëzhgimi, vlerësimi dhe regjistrimi i rrezikut që i kërcënohet nga mbeturinat e municioneve thërrmuese, duke bërë dhe të gjitha përpjekjet për të identifikuar të gjitha zonat e prekura me municione thërrmuese nën juridiksionin apo kontrollin e tij.

b) Vlerësimi dhe vendosja e nevojave parësore për sa i përket, shënjimit, mbrojtjes së civilëve, pastrimit dhe shkatërrimit, dhe marrjes së hapave për të mobilizuar burimet dhe për të zhvilluar një plan kombëtar për të kryer këto aktivitete, ndërtimin, ku është e mundur, mbi strukturat ekzistuese, përvojat dhe metodologjitë.

c) Ndërmarrja e të gjithë hapave të mundshëm për t'u siguruar që të gjitha zonat e prekura me municione thërrmuese nën juridiksionin apo kontrollin e tij janë të markuara në të gjithë perimetrin e tyre, janë të monitoruara dhe mbrojtura me gardhe ose mjete të tjera për të siguruar mbajtjen larg të civilëve prej tyre. Duhet të përdoren shenja paralajmëruese bazuar në metoda të markimit tashmë të njohura nga komuniteti afër tyre gjatë markimit të zonave të rrezikshme të dyshuara. Shenjat dhe markuesit e tjerë rrethues në zonat e rrezikshme duhet të jenë të dukshme e të lexueshme sa më larg që të jetë e mundur, duhet t'u rezistojnë dhe të jenë të qëndrueshme ndaj efekteve mjedisore dhe duhet që të identifikojnë qartë se cila anë e kufirit të markuar konsiderohet të jetë brenda zonave të prekura me municione thërrmuese dhe cila anë konsiderohet si e sigurt.

d) Pastrimi dhe shkatërrimi i të gjitha mbeturinave të municioneve thërrmuese të lokalizuara në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij; dhe

e) Organizimi i edukimit për reduktimin e rrezikut, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi te popullata civile që jeton në ose përreth zonave të prekura me municione thërrmuese për rreziqet që u kërcënohen nga mbeturina të tilla.

3. Gjatë kryerjes së aktiviteteve që përmenden në paragrafin 2 të këtij neni, çdo shtet palë duhet të marrë parasysh standardet ndërkombëtare, duke përfshirë standardet ndërkombëtare për veprimin kundër minave (IMAS).

4. Ky paragraf zbatohet në rastet kur municionet thërrmuese janë përdorur apo braktisur nga një shtet palë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë dhe që janë kthyer në mbeturina municionesh thërrmuese të cilët gjenden në zonat që janë nën juridiksionin apo kontrollin e një Shteti tjetër Anëtar në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë të fundit.

a) Në këto raste, me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për të dyja shtetet anëtare, shteti i parë anëtar inkurajohet shumë që t'i sigurojë, ndër të tjera, shtetit tjetër anëtar, ndihmesë teknike, financiare, materiale dhe për burimet njerëzore, ose në nivel dypalësh, ose nëpërmjet një pale të tretë për të cilën kanë rënë bashkërisht dakord, duke përfshirë nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara ose organizata të tjera përkatëse, për të lehtësuar shënjimin, pastrimin dhe shkatërrimin e këtyre mbeturinave të municioneve thërrmuese.

b) Një ndihmesë e kësaj natyre do të përfshijë, aty ku është e mundur, informacion në lidhje me llojet dhe sasitë e municioneve thërrmuese që janë përdorur, vendndodhjen e saktë të goditjeve të municioneve thërrmuese dhe zonat në të cilat dihet se ndodhen mbeturinat e municioneve thërrmuese.

5. Nëse një shtet anëtar mendon se nuk është në gjendje të pastrojë dhe të shkatërrojë ose të sigurojë pastrimin dhe shkatërrimin e të gjitha mbeturinave të municioneve thërrmuese që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni brenda dhjetë vjetëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet anëtar, ai mund të dorëzojë një kërkesë në takimin e shteteve anëtare ose në konferencën e rishikimit për shtyrjen e afatit për përfundimin e pastrimit dhe shkatërrimit të këtyre mbeturinave të municioneve thërrmuese për një periudhe prej deri në pesë vjetësh. Shtyrja e kërkuar nuk duhet të tejkalojë numrin e viteve që duhen domosdoshmërisht që ai shtet anëtar të përmbushë detyrimet e veta sipas paragrafit 1 të këtij neni.

6. Kërkesa për shtyrjen e afatit duhet t'i dorëzohet takimit të shteteve anëtare ose konferencës së rishikimit para skadimit të periudhës kohore që është përmendur në paragrafin 1 të këtij neni për atë shtet anëtar. Secila kërkesë duhet të dorëzohet minimumi nëntë muaj para takimit të shteteve anëtare ose konferencës së rishikimit në të cilën dhe do të trajtohet. Secila kërkesë do të parashtrojë:

a) kohëzgjatjen e shtyrjes së propozuar;

b) një shpjegim të detajuar të arsyeve të shtyrjes së kërkuar, duke përfshirë mjetet financiare dhe teknike që janë në dispozicion dhe ato që kërkohen nga shteti anëtar për pastrimin dhe shkatërrimin e të gjitha mbeturinave të municioneve thërrmuese gjatë shtyrjes së kërkuar të afatit;

c) përgatitjen e punës në të ardhmen dhe statusi i punës që është kryer tashmë sipas programeve kombëtare për pastrimin dhe çminimin gjatë dhjetë viteve të para që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni dhe shtyrjet e mëpasshme;

d) zonën totale që përmban mbeturina të municioneve thërrmuese në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet anëtar dhe zonat e tjera që përmbajnë mbeturina municionesh thërrmuese të cilat janë zbuluar pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

e) zonën totale që përmban mbeturina municionesh thërrmuese, të cilat janë pastruar që me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente;

f) zonën totale që përmban mbeturina të municioneve thërrmuese, të cilat mbeten të pastrohen gjatë shtyrjes së propozuar;

g) rrethanat që kanë penguar aftësinë e shtetit anëtar që të shkatërrojë të gjithë mbeturinat e municioneve thërrmuese në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij gjatë dhjetë viteve të para që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, dhe ato që mund të pengojnë këtë mundësi gjatë shtyrjes së propozuar të afatit;

h) implikimet humanitare, sociale, ekonomike dhe mjedisore të shtyrjes së propozuar; dhe

i) çdo informacion tjetër që lidhet me kërkesën për shtyrjen e propozuar.

7. Takimi i shteteve anëtare ose konferenca e rishikimit, duke marrë parasysh faktorët që përmenden në paragrafin 6 të këtij neni, duke përfshirë, ndër të tjera, sasitë e raportuara të mbeturinave të municioneve thërrmuese, do të marrë në shqyrtim kërkesën dhe do të vendosë me shumicë votash të shteteve anëtare që do jenë të pranishme, ku dhe do të votohet për të vendosur nëse do t'i miratohet kërkesa për shtyrjen e afatit. Shtetet anëtare mund të vendosin t'i japin një shtyrje afati më të shkurtër sesa ajo që kërkohet dhe mund të propozojë standardet për shtyrjen, sipas rastit.

8. Një shtyrje e tillë mund të rinovohet me një periudhë prej deri në pesë vjetësh pas dorëzimit të kërkesës, në përputhje me paragrafët 5, 6 dhe 7 të këtij neni. Për të kërkuar shtyrje të mëtejshme, shteti anëtar duhet të dorëzojë informacionin shtesë përkatës në lidhje me atë çfarë është bërë gjatë shtyrjes së mëparshme që është dhënë sipas këtij neni.

Neni 5
Ndihmesa ndaj viktimave

1. Secili shtet anëtar, në lidhje me viktimat e municioneve thërrmuese në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij, në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar dhe të drejtave të njeriut që është në fuqi, duhet të sigurojë ndihmesës sipas moshës dhe gjinisë, duke përfshirë kujdesin mjekësor, rehabilitimin dhe mbështetjen psikologjike, si dhe të mundësojë përfshirjen e tyre sociale dhe ekonomike. Secili shtet anëtar duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të mbledhur të dhënat përkatëse të besueshme në lidhje me viktimat e municioneve thërrmuese.

2. Gjatë përmbushjes së detyrimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni secili shtet anëtar:

a) do të vlerësojë nevojat e viktimave të municioneve thërrmuese;

b) do të zhvillojë, zbatojë dhe imponojë të gjitha ligjet dhe politikat e nevojshme kombëtare;

c) do të zhvillojë një plan dhe buxhet kombëtar, duke përfshirë dhe afatet kohore për të zbatuar këto aktivitete, me synimin për t'i përfshirë ato brenda kuadrit dhe mekanizmave ekzistues kombëtarë për paaftësitë, zhvillimin dhe të drejtat e njeriut, duke respektuar rolin specifik dhe kontributin e aktorëve përkatës;

d) do të ndërmarrë hapa për të mobilizuar burimet kombëtare dhe ndërkombëtare;

e) do të nuk do të ketë diskriminime kundër ose ndërmjet viktimave të municioneve thërrmuese, ose ndërmjet viktimave të municioneve thërrmuese dhe atyre që kanë pësuar dëmtime ose paaftësi nga shkaqe të tjera; ndryshime në trajtimet duhet të bazohen vetëm në nevojat mjekësore, rehabilituese, psikologjike ose social-ekonomike;

f) do të konsultohen ngushtësisht me dhe do të përfshijnë në mënyrë aktive viktimat e municioneve thërrmuese dhe organizatat e tyre përfaqësuese;

g) do të caktojnë një pikë qendrore brenda qeverisë për bashkërendimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e këtij neni; dhe

h) do të luftojë për të futur udhëzimet përkatëse dhe praktikat e mira në fushën e kujdesit mjekësor, rehabilitimit dhe mbështetjes psikologjike, si dhe përfshirjen sociale dhe ekonomike.

Neni 6

Bashkëpunimi dhe ndihmesa ndërkombëtare

1. Gjatë përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Konvente, secili shtet anëtar ka të drejtën të kërkojë dhe të marrë ndihmë.

2. Secili shtet anëtar, që është në këtë pozicion, do t'i japë ndihmesë teknike, materiale dhe financiare shteteve anëtare që janë prekur nga municionet thërrmuese, e cila ka si qëllim zbatimin e detyrimeve të kësaj Konvente. Një ndihmesë e tillë mund të sigurohet, ndër të tjera, dhe nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizatave ose institucioneve ndërkombëtare, rajonale apo kombëtare, ose mbi bazën e marrëdhënieve dypalëshe.

3. Secili shtet anëtar merr përsipër të ndihmojë dhe do të ketë të drejtën të marrë pjesë në shkëmbimin më të plotë të mundshëm të pajisjeve dhe informacionit shkencor e teknologjik që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente. Shtetet anëtare nuk do të imponojnë kufizime të tepruara në lidhje me sigurimin dhe mundësimin e pastrimit, si dhe pajisje të tjera dhe informacione përkatëse teknologjike për qëllime humanitare.

4. Përveç detyrimeve që mund të ketë sipas paragrafit 4 të nenit 4 të kësaj Konvente, secili shtet anëtar që ndodhet në këtë pozicion, do të sigurojë ndihmesë për pastrimin dhe shkatërrimin e mbeturinave të municioneve thërrmuese, si dhe informacione që lidhen me mjetet e ndryshme dhe teknologjitë që kanë të bëjnë me pastrimin e municioneve thërrmuese, si dhe një listë ekspertësh, agjencish eksperte apo pika kontakti në nivel kombëtar për pastrimin dhe shkatërrimin e mbeturinave të municioneve thërrmuese dhe aktivitetet që lidhen me to.

5. Secili shtet anëtar që gjendet në këtë pozicion, do të japë ndihmesë për shkatërrimin e stoqeve me municione thërrmuese, si dhe do të sigurojë ndihmesë për identifikimin, vlerësimin dhe vendosjen e nevojave parësore dhe masave praktike në lidhje me shënjimin e kufijve, edukimin për reduktimin e riskut, mbrojtjen e civilëve dhe pastrimin dhe shkatërrimin siç parashtrohet në nenin 4 të kësaj Konvente.

6. Në vendet ku, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, municionet thërrmuese janë kthyer në mbeturina të municioneve thërrmuese të lokalizuara në zona nën juridiksionin apo kontrollin e një shteti anëtar, secili shtet anëtar që ndodhet në këtë pozicion, do t'i sigurojë ndihmesë emergjente Shtetit Anëtar të prekur.

7. Secili shtet anëtar në këtë pozicion do të sigurojë ndihmesë për zbatimin e detyrimeve që përmenden në nenin 5 të kësaj Konvente për të siguruar ndihmesë sipas moshës dhe gjinisë së viktimave, duke përfshirë kujdesin mjekësor, rehabilitimin dhe mbështetjen psikologjike, si dhe për të siguruar përfshirjen sociale dhe ekonomike të viktimave të municioneve thërrmuese. Kjo ndihmesë mund të sigurohet, ndër të tjera, nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizatave apo institucioneve ndërkombëtare, rajonale apo kombëtare, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Shoqatës së Kryqit të Kuq Kombëtar dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare, organizatat joqeveritare ose në bazë marrëdhëniesh dypalëshe.

8. Secili shtet anëtar në këtë pozicion duhet të japë ndihmesë për të kontribuar në ripërtëritjen ekonomike dhe sociale që nevojitet si rezultat i përdorimit të municioneve thërrmuese në shtetet e prekura anëtare.

9. Secili shtet anëtar në këtë pozicion mund të kontribuojë në fondet përkatëse të besimit me

qëllim që të lehtësojë sigurimin e ndihmesës sipas këtij neni.

10. Secili shtet anëtar që kërkon dhe merr ndihmesë, do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura me qëllim që të lehtësojë zbatimin efikas dhe në kohë të kësaj Konvente, duke përfshirë lehtësimin e hyrjes dhe daljes së personelit, materialeve dhe pajisjeve, në një mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare duke marrë parasysh praktikat më të mira ndërkombëtare.

11. Secili shtet anëtar, me qëllimin për të hartuar një plan kombëtar veprimi, mund t'i kërkojë sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizatave rajonale, shteteve të tjera anëtare ose institucioneve të tjera kompetente ndërqeveritare ose joqeveritare që t'u vijë në ndihmë autoriteteve të tij për të vendosur (ndër të tjera) për:

a) natyrën dhe masën e mbeturinave të municioneve thërrmuese të lokalizuara në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij;

b) burimet financiare, teknologjike dhe njerëzore që kërkohen për zbatimin e planit;

c) kohën e llogaritur si të nevojshme për të pastruar dhe shkatërruar të gjitha mbeturinat e municioneve thërrmuese të lokalizuara në zonat nën juridiksionin apo kontrollin e tij;

d) programet për edukimin e reduktimit të riskut dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, me qëllim që të reduktohen plagosjet ose vdekjet e shkaktuara nga mbeturinat e municioneve thërrmuese;

e) ndihmesën ndaj viktimave të municioneve thërrmuese; dhe

f) marrëdhënien bashkërenduese ndërmjet qeverisë së shtetit anëtar të prekur dhe organizatave përkatëse qeveritare, ndërqeveritare ose joqeveritare, të cilat do të punojnë për zbatimin e planit.

12. Shtetet anëtare që do të japin dhe marrin ndihmesë sipas dispozitave të këtij neni, do të bashkëpunojnë për të siguruar zbatimin e plotë dhe të menjëhershëm të programeve për dhënien e ndihmesës.

Neni 7

Masat e transparencës

1. Secili shtet anëtar do t'i raportojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast kjo do të bëhet jo më vonë se 180 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për shtetin anëtar, për:

a) masat kombëtare të zbatimit që përmenden në nenin 9 të kësaj Konvente;

b) totalin e të gjitha municioneve thërrmuese, duke përfshirë nënmunicionet shpërthyese, që përmenden në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Konvente, duke përfshirë një analizë të llojeve të tyre, sasinë dhe, nëse është e mundur, numrat e serive të secilit lloj;

c) karakteristikat teknike të secilit lloj të municioneve thërrmuese prodhuar nga shteti anëtar para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, për atë sasi që njihet, si dhe ato që janë aktualisht nën pronësinë e tij, duke dhënë, aty ku është e mundur, këto kategori informacionesh të cilat mund të lehtësojnë identifikimin dhe pastrimin e municioneve thërrmuese; minimalisht, ky informacion duhet të përfshijë përmasat, shkrirjen/heqjen e siguresave, përmbajtjen shpërthyese, përmbajtjen metalike, fotografi me ngjyra dhe informacione të tjera që mund të lehtësojnë pastrimin e mbeturinave të municioneve thërrmuese;

d) statusin dhe progresin e programeve për shndërrimin ose nxjerrjen jashtë funksionit të mjeteve të prodhimit për municionet thërrmuese;

e) statusin dhe progresin e programeve për shkatërrimin, në përputhje me nenin 3 të kësaj Konvente, e municioneve thërrmuese, duke përfshirë nënmuniconet shpërthyese, me detajet e metodave që do të përdoren gjatë shkatërrimit të tyre, vendndodhjen e të gjitha vendeve të shkatërrimit dhe siguria e zbatueshme dhe standardet mjedisore që do të vëzhgohen;

f) llojet dhe sasitë e municioneve thërrmuese, duke përfshirë nënmunicionet shpërthyese, të shkatërruara në përputhje me nenin 3 të kësaj Konvente, duke përfshirë detajet e metodave të shkatërrimit që do të përdoren, vendndodhjen e vendit të shkatërrimit dhe sigurinë që do të zbatohet dhe standardet mjedisore që do të vëzhgohen;

g) stoqet e municioneve thërrmuese, duke përfshirë nënmunicionet shpërthyese, që janë zbuluar pas përfundimit të raportuar të programit që përmendet në nënparagrafin (e) të këtij paragrafi,

dhe planet për shkatërrimin e tyre në përputhje me nenin 3 të kësaj Konvente;

h) Deri në masën që do të jetë e mundur, përmasat dhe vendndodhjen e të gjitha zonave të prekura me municione thërrmuese që janë nën juridiksionin apo kontrollin e tij, duke përfshirë sa më shumë detaje që të jetë e mundur në lidhje me llojin dhe sasinë e çdo mbeturine të municioneve thërrmuese në secilën zonë dhe kur janë përdorur ato;

i) statusin dhe progresin e programeve për pastrimin dhe shkatërrimin e të gjitha llojeve dhe sasive të mbeturinave të municioneve thërrmuese të pastruara dhe të shkatërruara në përputhje me nenin 4 të kësaj Konvente, duke përfshirë përmasat dhe vendndodhjen e zonave të prekura me municione thërrmuese që janë pastruar, dhe një analizë të sasisë së secilit lloj të mbeturinave të municioneve thërrmuese që janë pastruara e shkatërruar;

j) masat e mara për të siguruar edukimin për reduktimin e riskut dhe, në veçanti, një paralajmërim të menjëhershëm dhe efikas për popullatën civile që jeton në zonat e prekura me municione thërrmuese nën juridiksionin apo kontrollin e tij;

k) statusin dhe progresin e zbatimit të detyrimeve të tij sipas nenit 5 të kësaj Konvente për të siguruar ndihmesë sipas moshës dhe gjinisë, duke përfshirë kujdesin mjekësor, rehabilitimin, dhe mbështetjen psikologjike, si dhe sigurimi i përfshirjes sociale dhe ekonomike së viktimave të municioneve thërrmuese dhe për të grumbulluar të dhëna të besueshme në lidhje me viktimat e municioneve thërrmuese;

l) emrat dhe hollësitë e kontakteve të institucioneve të caktuara për të siguruar informacionin dhe për të zbatuar masat e përshkruara në këtë paragraf;

m) sasinë e burimeve kombëtare, duke përfshirë ato financiare, materiale ose në natyrë, lidhur me zbatimin e neneve 3, 4 dhe 5 të kësaj Konvente; dhe

n) sasitë, llojet dhe destinacionet e bashkëpunimit dhe ndihmesës ndërkombëtare sipas nenit 6 të kësaj Konvente.

2. Informacioni që jepet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përditësohet nga shtetet anëtare çdo vit, duke mbuluar vitin paraardhës kalendarik, dhe do të raportohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara jo më vonë se 30 prilli i çdo viti.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'ia përcjellë të gjitha këto raporte që merr të gjitha shteteve anëtare.

Neni 8

Lehtësimi dhe qartësimi i zbatimit

1. Shtetet anëtare bien dakord të këshillohen dhe veprojnë me njëra-tjetrën në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente dhe të punojnë së bashku me një shpirt bashkëpunimi për të lehtësuar këtë zbatim nga shtetet anëtare sipas detyrimeve të tyre në bazë të kësaj Konvente.

2. Nëse një ose më shumë shtete anëtare dëshirojnë të qartësojnë apo të kërkojnë të zgjidhin çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente nga ana e një Shteti tjetër, mund t'i dorëzojë shtetit tjetër anëtar, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara një kërkesë për sqarime në lidhje me atë çështje. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e duhur. Çdo shtet anëtar duhet të përmbahet ndaj kërkesa për sqarime që janë të pabaza, duke treguar kujdes në shmangien e abuzimeve. Një shtet anëtar që merr një kërkesë për sqarim, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, brenda 28 ditëve, duhet t'i japë palës kërkuese të gjithë informacionin që do të ndihmonte në qartësimin e çështjes.

3. Nëse shteti anëtar kërkues nuk merr përgjigje nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara brenda asaj periudhe kohore, ose e konsideron si të pakënaqshme përgjigjen e kërkesës për sqarim, mund ta dorëzojë çështjen, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në takimin pasardhës të shteteve anëtare. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do ta transmetojë kërkesën, shoqëruar me të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me kërkesën për sqarim, tek të gjitha shtetet anëtare. I gjithë ky informacion do t'i prezantohet shtetit anëtar kërkues, i cili do të ketë të drejtën për t'u përgjigjur.

4. Në pritje të realizimit të takimit të shteteve anëtare, secili shtet anëtar mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që të kontribuojë duke ndihmuar në dhënien e sqarimeve të kërkuara.

5. Në rastin kur i është dorëzuar një çështje, sipas paragrafit 3 të këtij neni, takimi i shteteve anëtare fillimisht do të vendosë nëse do ta trajtojë çështjen më tej ose jo, duke marrë parasysh të gjithë informacionin që i është dorëzuar nga shteti anëtar në fjalë. Nëse vendos kështu, takimi i shteteve anëtare mund t'u sugjerojë shteteve anëtare mënyra dhe mjete të tjera për të qartësuar ose zgjidhur çështjen në fjalë, duke përfshirë fillimin e procedurave përkatëse në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Në rrethanat kur çështja në fjalë vendoset se është ashtu për shkak të rrethanave përtej kontrollit të shtetit anëtar kërkues, takimi i shteteve anëtare mund të rekomandojë masat e përshtatshme, duke përfshirë përdorimin e masave bashkëpunuese që përmenden në nenin 6 të kësaj Konvente.

6. Përveç procedurave që jepen në paragrafët 2 deri në 5 të këtij neni, takimi i shteteve anëtare mund të vendosë të miratojë këto procedura të tjera të përgjithshme ose mekanizma të posaçëm për qartësimin e përputhshmërisë, duke përfshirë fakte, dhe zgjidhjen e rasteve të moszbatimit të dispozitave të kësaj Konvente ashtu si mendohet se është më e përshtatshme.

Neni 9

Masat kombëtare të zbatimit

Secili shtet anëtar do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura ligjore, administrative ose masa të tjera për ta zbatuar këtë Konventë, duke përfshirë vendosjen e sanksioneve penale për të parandaluar dhe shmangur çdo aktivitet të ndaluar për një shtet anëtar sipas kësaj Konvente të ndërmarra nga persona ose në territorin që ndodhet nën juridiksionin apo kontrollin e tij.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur ka një mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve anëtare që lidhet me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, shtetet anëtare të përfshira në këtë mosmarrëveshje do të konsultohen me qëllimin që të arrihet një zgjidhje e shpejtë e mosmarrëveshjes nëpërmjet negociatave ose me anë të mjeteve të tjera paqësore sipas zgjedhjes së tyre, duke përfshirë mbështetjen e takimit të shteteve anëtare dhe duke iu referuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Takimi i shteteve anëtare mund të kontribuojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me të gjitha mjetet që shihen të arsyeshme, duke përfshirë ndihmën e tij të vlefshme, duke i bërë thirrje shteteve anëtare të përfshira të fillojnë procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas zgjedhjes së tyre dhe duke rekomanduar një afat kohor për çdo procedure për të cilën do bihet dakord.

Neni 11

Takimet e shteteve anëtare

1. Shtetet anëtare do të takohen rregullisht me qëllim që, aty ku është e nevojshme, të marrin parasysh dhe të marrin vendime në lidhje me çdo çështje që lidhet me zbatimin ose zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë:

a) operimin dhe statusin e kësaj Konvente;

b) problemet që vijnë nga raportet që janë dorëzuar sipas dispozitave të kësaj Konvente;

c) bashkëpunimin dhe ndihmesën ndërkombëtare në përputhje me nenin 6 të kësaj Konvente;

d) zhvillimin e teknologjive për pastrimin e mbeturinave të municioneve thërrmuese;

e) raportet e shteteve anëtare sipas nenit 8 dhe 10 të kësaj Konvente; dhe

f) raportet e shteteve anëtare sipas neneve 3 dhe 4 të kësaj Konvente.

2. Takimi i parë i shteteve anëtare do të organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Takimet e mëpasshme do të organizohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara çdo vit deri në konferencën e parë të rishikimit.

3. Shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, organizata apo institucione të tjera përkatëse ndërkombëtare, organizatat rajonale, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqata e Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe organizata

të tjera joqeveritare mund të ftohen që të marrin pjesë në këto takime si vëzhgues në përputhje me rregullat e vendosura të procedurës.

Neni 12
Konferencat e rishikimit

1. Një konferencë rishikimi do të organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Konferencat e tjera të rishikimit do të organizohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nëse kjo gjë do të kërkohet nga një ose më shumë nga shtetet anëtare, me kusht që intervali ndërmjet konferencave të raportimit të jetë më pak se pesë vjet. Të gjitha shtetet anëtare në këtë Konventë do të ftohen në çdo konferencë rishikimi.

2. Qëllimi i konferencës së rishikimit do të jetë:

a) të rishikojë funksionimin dhe statusin e kësaj konvente;

b) të marrë në konsideratë nevojën për dhe intervalin ndërmjet takimeve të mëtejshme të shteteve anëtare që përmendet në paragrafin 2 të nenit 11 të kësaj Konvente; dhe

c) të marrë vendime për raportimet e shteteve anëtare, siç parashtrohet në nenet 3 dhe 4 të kësaj Konvente.

3. Shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, organizatat apo institucionet e tjera përkatëse, organizatat rajonale, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe dhe organizata të tjera përkatëse joqeveritare mund të ftohen për të marrë pjesë në të gjitha konferencat e rishikimit si vëzhgues në përputhje me rregullat e vendosura procedurale.

Neni 13
Ndryshimet

1. Në çdo moment, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, secili shtet anëtar mund të propozojë ndryshime për këtë Konventë. Çdo propozim për ndryshime do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ia qarkullojë atë të gjitha shteteve anëtare dhe do të kërkojë mendimin e tyre për faktin nëse duhet të mblidhet një konferencë ndryshimi apo jo për të shqyrtuar këtë propozim. Nëse pjesa më e madhe e shteteve anëtare njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit se ata janë në mbështetje të propozimit, atëherë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të mbledhë një konferencë ndryshimi në të cilën do të ftohen të marrin pjesë të gjitha shtetet anëtare.

2. Shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, organizata apo institucione të tjera përkatëse ndërkombëtare, organizata rajonale, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq, Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe organizata përkatëse joqeveritare mund të ftohen të marrin pjesë në çdo konferencë ndryshimi si vëzhgues, në përputhje me rregullat e vendosura procedurale.

3. Konferenca e ndryshimit do të mbahet menjëherë pas takimit të shteteve anëtare ose konferencës së rishikimit, me përjashtim të rasteve kur pjesa më e madhe e shteteve anëtare kërkon që ajo të organizohet më shpejt.

4. Çdo ndryshim i kësaj Konvente do të miratohet nga pjesa më e madhe prej dy të tretat e shteteve anëtare të pranishme dhe duke votuar në konferencën e ndryshimit. Depozituesi do të komunikojë çdo ndryshim që miratohet tek të gjitha shtetet.

5. Një ndryshim i kësaj Konvente do të hyjë në fuqi për shtetet anëtare të cilat e kanë pranuar ndryshimin në datën e depozitimit të pranimeve nga pjesa më e madhe e shteteve të cilat ishin dakord në datën e miratimit të ndryshimit. Si rrjedhim ai do të hyjë në fuqi dhe për shtetet anëtare që mbeten në datën e depozitimit instrumentit të pranimit të tij.

Neni 14
Kostot dhe detyrat administrative

1. Kostot e takimeve të shteteve anëtare, konferencat e rishikimit dhe konferencave të ndryshimeve do të mbarten nga shtetet anëtare dhe shtetet që nuk janë anëtare në këtë Konventë por që marrin pjesë, në përputhje me shkallën e vlerësimit të Shteteve të Bashkuara të rregulluar përkatësisht.

2. Kostot që vijnë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Konvente, do të paguhen nga shtetet anëtare në përputhje me klasifikimin e vlerësimit të Kombeve të Bashkuara të rregulluar përkatësisht.

3. Kryerja e detyrave administrative nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që i janë caktuar atij ose asaj sipas kësaj Konvente është objekt i një mandati përkatës të Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

Nënshkrimi

Kjo Konventë, realizuar në Dublin më datën 30 maj 2008, do të hapet për t'u nënshkruar në Oslo nga të gjitha shtetet më datën 3 dhjetor 2008 dhe më pas në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri në hyrjen e saj në fuqi.

Neni 16

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është objekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga nënshkruesit.

2. Ajo do të jetë e hapur për t'u pranuar nga çdo shtet që nuk e ka firmosur Konventën.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose rënies dakord do të depozitohen tek depozituesi.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të gjashtë muajve pas muajit në të cilin është depozituar instrumenti i tridhjetë i ratifikimit, pranimit, miratimit apo rënies dakord.

2. Për çdo shtet që depoziton instrumentin e vet të ratifikimit, pranimit, miratimit apo rënies dakord pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo rënies dakord, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të gjashtë pas datës në të cilën ai shtet ka depozituar instrumentin e vet të ratifikimit, pranimit, miratimit apo rënies dakord.

Neni 18

Zbatimi provizor

Secili shtet, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, mund të deklarojë që do ta zbatojë provizorisht nenin 1 të kësaj Konvente, duke lënë pezull hyrjen në fuqi të saj për atë shtet.

Neni 19

Rezervimet

Nenet e kësaj Konvente nuk do të jenë objekt i rezervimeve.

Neni 20

Kohëzgjatja dhe tërheqja

1. Kjo Konventë do të jetë me një kohëzgjatje të pacaktuar.

2. Çdo shtet anëtar, duke ushtruar të drejtat e veta kombëtare, ka të drejtën të tërhiqet nga kjo Konventë. Për këtë tërheqje ai duhet të njoftojë të gjitha shteteve të tjera anëtare, depozituesin dhe Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Ky instrument i tërheqjes do të përfshijë një shpjegim

të plotë të arsyeve që kanë çuar në këtë tërheqje.

3. Tërheqja do të hyjë në fuqi vetëm pas gjashtë muajve pas marrjes së instrumentit të tërheqjes nga depozituesi. Nëse ndodh që gjatë skadimit të asaj periudhe gjashtëmujore, shteti anëtar të jetë i angazhuar në konflikt të armatosur, tërheqja nuk do të hyjë në fuqi para përfundimit të konfliktit të armatosur.

Neni 21

Marrëdhëniet me shtetet që nuk janë anëtare në këtë Konventë

1. Çdo shtet anëtar do të inkurajojë shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë që të ratifikojnë, pranojnë, miratojnë apo të bien dakord me këtë Konventë, me qëllimin për të tërhequr më shumë anëtarë nga të gjitha shtetet në këtë Konventë.

2. Çdo shtet anëtar do të njoftojë qeveritë e shteteve që nuk janë anëtare në këtë Konventë, që përmenden në paragrafin 3 të këtij neni, për detyrimet e veta sipas kësaj Konvente, do të promovojë normat që ka vendosur dhe do të bëjë përpjekjet më të mëdha që të dekurajojë shtetet që nuk janë anëtare në këtë Konventë në përdorimin e municioneve thërrmuese.

3. Pavarësisht dispozitave të nenit 1 të kësaj Konvente dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, shtetet anëtare, personeli i tyre ushtarak apo qytetarët e tyre, mund të përfshihen në bashkëpunime dhe operacione ushtarake me shtetet që nuk janë anëtare në këtë Konventë të cilat mund të jenë pjesë e aktiviteteve që janë të ndaluara për një shtet anëtar.

4. Asnjë pikë në paragrafin 3 të këtij neni nuk do ta autorizojë një shtet anëtar:

a) të zhvillojë, prodhojë apo marrë në ndonjë formë municione thërrmuese;

b) të krijojë vetë ose të transferojë stoqe me municione thërrmuese;

c) të përdorë vetë municione thërrmuese; ose

d) të kërkojë në mënyrë të qartë përdorimin e municioneve thërrmuese në rastet kur zgjedhja e municioneve të përdorura është nën kontrollin e vet ekskluziv.

Neni 22

Depozituesi

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është caktuar si depozituesi i kësaj Konvente.

Neni 23

Tekstet autentike

Tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të kësaj Konvente do të jenë njësoj autentike.